




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 27.06.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 622, të datës 13.06.2019, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2020 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,608,366.00€;
 - 1.2 Për vitin 2021 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,957,371.00€;
 - 1.3 Për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 13,336,910.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022 është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivit.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 12.07.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 625, të datës 14.06.2019, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 35, paragrafi 8, i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr. 013 - 2056, me numër të protokollit 24, të datës 18.04.2017, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për refuzimin e Propozimit Nr. 625, të datës 14.06.2019 për pagesën e pagave jubilarë pas pensionimit të punëtorëve në arsim

1. Për refuzimin e Propozimit Nr. 625, të datës 14.06.2019 për pagesën e pagave jubilarë pas pensionimit të punëtorëve në arsim.
2. Realizimi i të drejtave të punëtorëve në arsim për pagat jubilarë bëhet në përputhje me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr. 013 - 2056, me numër të protokollit 24, të datës 18.04.2017, e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

